

SHPRESA ISMAJLI

FJALËFORMIMI NË ROMANET E REXHEP QOSJES

PARASHTESIMI

Hyrje

Leksiku i shqipes u pasurua ndjeshëm nga pena e shumë shkrimtarëve tanë të shquar, të cilët bënë përpjekje të pareshtura për ta zhvilluar e për ta begatuar gjuhën tonë. Kërkesa për krijimin e fjalëve të reja me mjete e mënyra të shqipes u shtua sidomos në periudhën e Rilindjes, duke qenë se fushata e pastrimit të gjuhës nga fjalët e huaja shfaqte menjëherë nevojën e zëvendësimit të tyre me fjalë të brumit të shqipes. Prandaj, edhe numri i fjalëve të reja të krijuara, veçanërisht në këtë periudhë, është mjaft i madh.

Fjalëformimi vërtet është një nga mekanizmat gjuhësorë më të rëndësishëm që siguron pafundësinë e leksikut.¹ Mirëpo, dihet që, një numër fjalësh të reja të krijuara përgjatë viteve kanë mbetur të përdorura vetëm në veprat e shkrimtarëve që i kanë krijuar, e shumë prej tyre kanë hyrë në përdorim të përgjithshëm e janë bërë pjesë e leksikut të shqipes.

Njëri ndër shkrimtarët që e ka pasuruar shqipen me fjalë të reja e me vlera të reja shprehëse është edhe Rexhep Qosja. R. Qosja, si mjeshtër i fjalës shqipe, ka krijuar shumë fjalë të reja nga lënda gjuhësore e shqipes, sipas gjedheve të njohura të gjuhës. Me pasurimin që i sjell R. Qosja shqipes përmes krijimit të fjalëve të reja me anë të parashtesave do të merremi në këtë punim, duke vënë në pah parashtesat më prodhimtare në krijimtarinë e tij, rolin e tyre, kuptimin e fjalës së prejardhur, ngjyrimin kuptimor etj.

Parashtesimi në romanet e Rexhep Qosjes

Romanet R. Qosjes, ndër të tjera, shquhen për pasuri leksikore. Ky fond leksikor, përfshin shumësi njësisht leksikore, një numër i madh i të cilave janë krijime të vet autorit, vepra e të cilit e ka provuar qartësisht se

¹ J. Thomaj, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989, f. 169.

mundësitë e brendshme të shqipes për krijime të reja janë të mëdha. Mund të pohohet se R. Qosja ka shfrytëzuar gjerësisht mundësitë e aftësitë fjalëformuese të shqipes duke zgjeruar leksikun e gjuhës standarde me fjalë të reja, me kuptime të reja, me nuanca e ngjyime të shumta emocionuese e shprehëse, ka zgjeruar e ka mbushur çerdhet e vargjet fjalëformuese të fjalëve etj. R. Qosja ka gjallëruar mjetet e modelet fjalëformuese të shqipes standarde, po ka shfrytëzuar edhe gjedhet fjalëformuese nga ligjërimi popullor e dialektor, veçanërisht nga gegërishtja verilindore, po edhe mënyra vetjake të fjalëformimit.

Mënyrat më prodhimtare të formimit të fjalëve në romanet e R. Qosjes janë prapashtesimi dhe kompozimi, por nuk anë të pakta as fjalët e krijuara me parashtesim, të cilat janë objekt i këtij punimi. Korpusin e punimit tonë e përbëjnë ato njësi leksikore të përdorura në romanet e R. Qosjes të cilat nuk pasqyrohen në fjalorët shpjegues të shqipes. Një numër i madh i këtyre fjalëve janë krijime të vet autorit, por disa mund t'i ketë marrë nga të folmet dialektore e të folmet e qyteteve, nga krijimtaria popullore, nga shkrimtarët e ndryshëm, nga shkrimet publicistike etj. Edhe pse është e vështirë të përcaktojmë saktë numrin e fjalëve që i ka krijuar vetë R. Qosja, si krijime të tij do të merren ato njësi leksikore që paraqesin veçanti të gjuhës e të stilit të tij.

Formimi i fjalëve të reja me anë të parashtesave është mënyrë mjaft e rëndësishme e fjalëformimit në gjuhën shqipe. Parashtesimi, si tip fjalëformimi, del i pasur në veprën e R. Qosjes. Me anën e parashtesave R. Qosja ka formuar një numër emrash e mbiemrash, më pak folje e ndajfolje me kuptime të ndryshme e me shkallë të lartë të shprehësisë. Parashtesat më prodhimtare në krijimtarinë e tij: *ç-*, *mos-*, *pa-*, *jo-*, *për-*, *para-*, *pas-*, *mbi-*, *nën-*, *jo-*, *sapo-* etj. Ndër to, parashtesat që më së shumti ka shfrytëzuar R. Qosja për formimin e fjalëve janë: *ç-*, *për-*, *pa-*, *mos-* etj.

Me parashtesën *-ç* në veprën e Qosjes janë formuar emra, mbiemra, folje e ndajfolje, si: *çmoralizim*, *çmarrëdhënie*, *çrregullsi*; *i çbarazpeshuar*, *i çkishëruar*, *i çelektrizuar*, *i çegërsuar*, *i çmësuar*; *çtërheq*, *çpaketoj*, *çngujoj*, *çmitizoj*, *çdenjësoj*, *çndihmoj*, *çsuvatoj*; *çorientueshëm* etj. Siç dihet, formimet me këtë parashtesë shënojnë kuptim të kundërt me kuptimin e shprehur nga tema fjalëformuese.

Në gjuhën shqipe parashtesa *ç-* është karakteristike për formimin e foljeve dhe të disa mbiemrave. Formimet mbiemërore me këtë prapashtesë në romanet e Qosjes janë kategoria më e pasur, të formuara nga mbiemri përkatës dhe parashtesa *ç-*, edhe pse në ndonjë rast (*i çkishëruar*) nuk ekzistojnë si fjalë me vete mbiemrat gjegjës pa parashtesë e as foljet

përkatëse me këtë parashtesë. Formimet e tilla mund t'i marrim si të motivuara nga parashtesimi i mbiemrit ose nga paranyjëzimi i pjesoreve të foljeve përkatëse (me parashtesën ç-).

Formimet emërore me këtë parashtesë, e aq më pak ato ndajfoljore nuk janë karakteristike për shqipen, R. Qosja i ka krijuar për të arritur efekte stilistike të ndryshme, p.sh.:

Ata që shkencën dhe artin modern perëndimor i kanë shpallur antishkencë dhe antiart, që dëshmon shfytyrimin dhe çmoralizimin e botës perëndimore! (Bijtë e askujt I, f. 58)

Që të gjithë u pajtuan se mbledhja ishte e suksesshme, se në këtë OTH procesi i diferencimit është kuptuar drejt, por disa elementë, si ata që heshtën e në mënyrë të veçantë si ai Çerem Çapari, mund të ndikojnë çorientueshëm në të tjerët, në mënyrë të veçantë në të rinjtë tanë. (Një dashuri e shtatë faje, f. 408)

Foljet me parashtesën ç-, R. Qosja i ka përdorur bashkë me gjegjëset e tyre pa parashtesë, duke krijuar njësi leksikore antonimike që rrisin ndjeshëm shprehësinë e thënies. P.sh.

Dhe tani, nuk të merr as gjumi i natës, si netëve të përparme. Ngihesh, shpesh, prej shtratit, nga tri katër herë, çel dritaret, i tërheq dhe çtërheq perdet, i lan duart, këmbët, qafën, gjoksin – thujase lan mëkatet e vetës dhe të botës, por kot. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, f. 167)

E tregova fatkeqësinë e Man Kurtiti i vetëdëshëm se me kujtimet nuk mund t'i ndihmoj askujt e as t'i çndihmoj vetes! (Një dashuri e shtatë faje, f. 158)

Një parashtesë mjaft prodhimtare në krijimtarinë e Qosjes është edhe parashtesa për-, formimet me të cilën janë bërë veçori e stilit të tij. Me këtë parashtesë R. Qosja ka krijuar emra, mbiemra e folje, si: *përfolje*, *përshtrirje*, *përbrendësi*, *përtashësi*, *përditësi*, *përfolshmëri*, *përqurran*, *përbjargan*, *i përfjetur*, *i përfryrë*, *përngij* etj. Këto janë kryesisht formime të gjuhës librore. Sipas mënyrës së formimit disa nga këto fjalë janë formime prapashtesore, por po i përmendim këtu për ta treguar prodhimtarinë e parashtesës. P.sh.: emrat *përhijim* (nga *përhijon*) dhe *përfolje* (nga *përfol*) janë formime prapashtesore, por foljet prej nga

rrjedhin ato janë formime me parashtesën *për-*. Po kështu, edhe emri *përditësi* “gjëra a punë të përditshme” (nga *përditë*).

Emrat *përfolshmëri* “pëshpëritje, thashetheme” (i formuar me parashtesim dhe prapashtesim njëkohësisht *për+ i folshëm+ ëri*) dhe *përtashësi* “koha e tanishme” (që mund të jetë formuar me parashtesim dhe prapashtesim njëkohësisht *për+ tash + ësi*, apo nga tema mbiemërore *i përtashëm + -ësi*) i kemi konsideruar formime me parashtesën *për-* (edhe pse nuk ekzistojnë si fjalë më vete *tashësi dhe folshmëri*), duke u bazuar në pasurinë e madhe të kategorisë së emrave abstraktë me këto prapashtesa në veprën e Qosjes.

Vajazanin do ta pushtojë pëshpëritja: Çerem Çapari i sulmuar prej qenit dhe i përplasur për tokë në mes të rrugës së Currit! Çka s’do të ngjajë në qytetin tonë kryesor! Përfolshmëri - gjithfarësh. (Një dashuri e shtatë faje, f. 356)

Nuk ka dyshim se këto shënime, herë citate më të gjata nga veprat e lexuara e herë përshtypje e përsiatje të frymëzuara prej përtashësisë a prej tyre, pashmangshëm ndikojnë në përbërjen e veprës që po botoj. (Një dashuri e shtatë faje, f. 12)

Një parashtesë tjetër, po ashtu mjaft prodhimtare, është edhe parashtesa *pa-*, me të cilën R. Qosja ka formuar një numër të madh mbiemrash. Këta janë mbiemra me kuptim antonimik me mbiemrin që shërben si temë fjalëformuese, që mund të jetë mbiemër i formuar nga nyjëzimi i pjesores apo mbiemër me parashtesën *-shëm*: *i padiktuar*, *i paburgosur*, *i pasëmurë*, *i padukur*; *i pahidhërueshëm*, *i pafyeshëm*, *i paplagosshëm*, *i pazhdukshëm*, *i parefuzueshëm*, *i papërngutshëm*, *i pashkërdhyer* etj.; nga nyjëzimi i togut parafjalor: *i pagrada*; dhe nga ndajfoljet: *padjallëzor* etj.

Parashtesa tjetër mjaft prodhimtare në romanet e Qosjes është edhe *mos-*, e cila po ashtu u jep fjalëve kuptim të kundërt. Kjo parashtesë bashkohet me tema fjalëformuese emërore e brenda tyre vetëm me disa kategori strukturore e kuptimore të caktuara emrash, kryesisht emra foljorë e mjaft rrallë me tema mbiemërore.² Me këtë prapashtesë te R. Qosja kemi: *mosdurim*, *mosrend* (*parregullsi*, *çrregullim*), *moskënaqësi* etj. Siç shihet,

² E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2004, f. 82.

emrat foljorë të veprimit me parashtesën *mos-* janë mjaft të shpeshtë, por përveç me emra prejfoljorë të veprimit, kjo parashtesë është bashkuar edhe me emra abstraktë të cilësisë me *-ësi*, megjithëse për këtë kategori *emrash sot është specializuar parashtesa pa-*.³ Këto formime bien ndesh me rregullat e fjalëformimit të shqipes, janë krijime rastësore të paqëndrueshme në gjuhë, të cilat R. Qosja i përdor për efekte stilistike. P.sh.:

*E këqyri dhomën: a është çdo gjë në vend të vet pas tërmetit, mund të vijë kush, që i këqyr sendet dhe prej **mosrendit** mund të kuptoj se këtu ka ngjarë diçka që nuk është dashur të ngjasë- në asnjë mënyrë! (Një dashuri e shtatë faje, f. 268)*

Më pak prodhimtare është parashtesa *jo-*, me të cilën janë krijuar disa emra, mbiemra: *jofqinj, jonjeri, jomodesti, joshkrimtar, joironikisht* etj. Edhe formimet me këtë parashtesë R. Qosja i përdor kryesisht për qëllime stilistike. Bashkimi i parashtesës *jo-* me tema emërore nuk është karakteristik për shqipen e sotme letrare, *jo-*ja që qëndron para emrave si element parashtesor, ndihet në njëfarë mënyre e veçuar nga tema fjalëformuese⁴.

Mjaft prodhimtare në veprën e R. Qosjes është edhe parashtesa *nën-*, që vjen nga parafjala *nën*, me të cilën janë krijuar emrat: *nënkërthizë, nënstrehë, nënkulm* (sipas nënçati), *nënnjeri*, të cilat përdoren me kuptim terminologjik. P.sh.:

*... dhe, e dyta, që pas çdo leximi të këtyre fjalive, ta freskonte Ndrecën me shurrë prej **nënkërthizës** e deri në fytyrë, por duke u ndalur, gjatë, gjatë, gjatë në fytyrën e tij. (Nata është dita jonë, f. 370)*

*Sot, më 3 janar 2001, kur po e filloj shkrimin e këtij romani të ri me të cilin do të marr pjesë në konkursin e Ministrisë sonë të Kulturës për romanin më të mirë të vitit të parë të mijëvjeçarit të tretë, mund t'i siguroj lexuesit e pritshëm, se këtu, në këtë vepër, do të gjejnë, njëkohësisht, pamje, përshkrime, ballafaqime, dinakëri, dashuri e urrejtje, sjellje njeriu e **nënnjeriu**, domethënie të drejtpërdrejta e të anasjellta, prej të cilave do të mund të tronditet ndërgjegjja e tyre, por do të tronditet, vërtet, në qoftë*

³ Grup autorësh, *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë, 1966, f. 205.

⁴ E. Hysa, *libri i cituar*, f. 87.

se nuk është topitur deri tani prej tronditjeve aq shpesh të përsëritura në jetën e Vajazanit. (Nata është dita jonë, f. 8)

Siç shihet, togu *sjellje nënnjeriu* është përdorur me ngjyrim negativ, me kuptimin sjellje e ulët.

Parashtesë tjetër është *mbi-*, me origjinë parafjalore, e cila nga pikëpamja kuptimore “jep idenë e një sendi a një veprimi që gjendet a që ndodh përmbi një tjetër”.⁵ Me këtë parashtesë R. Qosja ka krijuar emrin *mbifuqi* dhe ndajfoljen *mbimesatraisht*, që janë po ashtu formime të gjuhës librore.

Një parashtesë tjetër që ka shfrytëzuar R. Qosja është parashtesa *pas-*, me të cilën ka formuar emrin *passhuplakë* “parakrah”, i cili mund të përdoret si term. P.sh.:

Në gishtërinjtë dhe në passhuplakat e duarve të saj shkëlqenin stoli me vlerë të jashtëzakonshme: diamante, gurë xhevahiri, smeraldë. (Bijtë e askujt, f. 424)

Me parashtesat ndajfoljore *para*, *prapa*, *posa* të cilat i ruajnë kuptimet e kohës dhe hapësirës, janë krijuar mbiemrat: *i posaqitur* “i sapodalë”, si dhe emrin *parasallë* “kthinë në hyrje të një salle”, sipas *paradhomë*.

Me parashtesën *tej-*, e cila bart kuptimin e ndajfoljes, te R. Qosja kemi mbiemrin *i tejendosur* “shumë i tendosur”, dhe foljen *tejshkoj* “kalon, tejkalon”, të dyja me kuptim intensiv. P.sh.:

Sa mirë që nuk më ke harruar, sa mirë thotë dhe i kërcëllin dhëmbët, qesh të madhe e qeshja e tij i tejshkon muret, hyn brenda e mbush xhaminë, ngritet përpjetë dhe lidhet rreth minares. (Vdekja më vjen pre syve të tillë, f. 236)

Rexhep Qosja, në krijimtarinë e tij përdor shumë pak mjete fjalëformuese të huaja, kryesisht për efekte stilistike. Më të shpeshtat janë: *kontra*, *anti*, *pro*, *neo*, *pseudo*, *mega*, *mikro*: *kontrarevolucion*, *kontrarevolucionar*, *antidrejtësi*, *antishkencë*, *antiart*, *antipopullor*, *profashist*, *neokolonializim*, *neoshqiptarizëm*, *pseudohistorian*, *pseudoshkrimtar*, *megavaginë*, *megaçmim*, *mikropërgjues* etj. Këto mjete

⁵ Grup autorësh, *libri i cituar*, f. 208.

fjalëformuese, të bashkuara me tema fjalëformuese të huaja po edhe me tema fjalëformuese shqipe janë të përdorura pothuajse gjithmonë me ngjyrim negativ. Përgjithësisht bën vetë emri *mikropërgjues* “aparati i vogël për përgjim”, që ka kuptim emërtues. P.sh.:

*Vetëm i Madhi Zot, xheleshanu hu, vetëm Jezui dhe Muhameti, mund ta dinë sa spermat e ndryshme, të ardhura prej kontinenteve të ndryshme, janë derdhur gjatë shekujve, gjatë shumë shekujve, prej kohës së Perandorisë Romake e deri në kohën e Perandorisë Sovjetike mes kofshëve të grave të këtij nënqielli – në **megavaginën** kombëtare! (Bijtë e askujt, II, f. 321)*

*Natyrisht, do të ftohen edhe përfaqësues ose, të shprehem më saktësisht, zëdhënës të të çmendurve nga vendet fqinje, në radhë të parë nga Shqipëria, nga Serbia, nga Maqedonia dhe nga Mali i Zi. Shkurt e shqip: madhësia, bukuria, cilësia, themelet, dritaret, pullazimi, dekorimet, inaugurimi - ja arsyet e **megaçmimit** të Shtëpisë së të Çmendurve. (Nata është dita jonë, f. 187)*

Në veprën e R. Qosjes vërehet qartë prirja e tij për t'i zëvendësuar mjetet e huaja fjalëformuese me mjete fjalëformuese të shqipes. Kështu në vend të parashtesave të huaja, ai përdor gjegjëset shqipe: *kundër-*, *gjysmë-* etj. si: *kundërplumb*, *kundërpartiak*, *kundërshtetërore*, *kundërnatyrore*, *kundërtrup*, *kundërvirus*, *kundërkrijuese*, *kundërartistike*, *gjysmëmaturë* etj. P.sh.

*Budin Buda, i quajtur Kentauri, vazhdon të ecë si kapedan: Idioti, Zifti dhe Belbani vazhdojnë t'i shkojnë pas gjoksfryrë si të kishin veshur **kundërplumb**, kurse numri i qytetarëve kureshtarë, sidomos, i fëmijëve, që na rrethojnë, vazhdon të shtohet. (Nata është dita jonë, f. 38)*

*Anton kreshtën e kishte pasur shok shkolle deri në **gjysmëmaturë...** (Bijtë e askujt, f. 400)*

*Realizmi socialist, thoshte shumë i bindur, është doktrinë primitive **kundërartistike** dhe **kundërshkencore**, sepse nuk e lejon krijuesin të krijojë të mendojë e të shkruajë çka dëshiron e di ai... (Bijtë e askujt, f. 314)*

Përfundim

Qosja ka krijuar një jo të vogël fjalësh me parashtesa, të cilat kanë kuptime e me ngjyrimë të ndryshme emocionale e stilistike. Më të pasurat janë formimet me parashtesat *ç-*, *për-*, *pa-*, *mos -*, *jo-*, *nën-*, etj., shumica prej të cilave formojnë njësi leksikore të ligjërimit të shkruar, disa prej të cilave mund të përdoren në fusha të ndryshme të terminologjisë.

Mjaft prodhimtare në veprën e tij na del parashtesa *-ç*, me të cilën Qosja ka formuar emra, mbiemra, folje e ndajfolje. Formimet emërore dhe ato foljore me këtë parashtesë, janë karakteristikë e gjuhës dhe stilit R. Qosjes të cilat i përdor për efekte stilistike.

Njëra nga parashtesat mjaft prodhimtare, që po ashtu është veçori e gjuhës së R. Qosjes është edhe parashtesa *për-*, me të cilën ka krijuar emra, mbiemra e folje. Mjaft prodhimtare janë edhe formimet me parashtesat mohuese *pa-*, *mos-*, *jo-*.

Ndër formimet parashtesore të R. Qosjes, kategoria leksiko-gramatikore më e pasur janë emrat, pastaj vijnë mbiemrat, foljet e ndajfoljet janë më të pakta. Formimet parashtesore emërore më të pasura janë ato me parashtesat *ç-*, *mos-*, *për-* etj., ndërsa formimet mbiemërore më të shumta janë krijuar me parashtesat antonimike *ç-* dhe *pa-*.

BIBLIOGRAFI

- Buxheli, L., *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008.
- Grup autorësh. *Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve*. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1972- I, 1989-III.
- Grup autorësh. *Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, 2005.
- Grup autorësh. *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2002.
- Grup autorësh. *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2002.
- Grup autorësh, *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë 1966, f. 205.

- Hysa, E., *Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2004.
- Lloshi, Xh., *Stilistika dhe pragmatika*. Tiranë: Albas, 2001.
- Thomai, J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Toena, 2002.
- Thomaj, J., *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*. Tiranë, 1989.
- Xhuvani, A. - Çabej, E., *Parashtesat e gjuhës shqipe*. Tiranë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1980.
- Xhuvani, A. - Çabej, E., *Prapashtesat e gjuhës shqipe*. Tiranë: Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1962.

